

# NewsLetter



Years

THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

## OPINION EKONOMIK

### Raportimi financiar dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të bizneseve në kushtet e COVID-19

**Kledi Kodra,**  
Managing Partner, Grant Thornton

» Continues on Page 4

## » EKONOMI «

### PËR GARANCINË SOVRANE ME QËLLIM RIMËKËMBJEN E BIZNESIT

**B**azuar në miratimin së fundmi të VKM-së Nr. 387, datë 13.5.2020, "Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të Marrëveshjes së Garancisë dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit" botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 87, datë 15.05.2020, Këshilli i Ministrave ka vendosur si më poshtë vijon:

» Vijnë në faqen 3

## PRESIDENTI JAÇO DHE PËRFAQËSUES TË AMCHAM



# takojnë Kryetarin e PD-së, z. Lulzim Basha



Në faqen 2

## SITUATA E JASHTËZAKONSHME

### Kush janë të drejtat që mund të na kufizohen

» Page 3

### Si kufizohet turizmi nga pengimi i lëvizjes së lirë

» Në faqen 2

## COVID 19- ECONOMIC NEWS



» On page 5

### RAMA: BY MAY, THE COUNTRY WILL BE COMPLETELY OPEN – MONITOR.AL

Nga janari i vitit 2021, bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë emrat e 20 huamarrësve më të mëdhenj - Monitor.al

Fine of 50 thousand ALL for employers who do not apply for financial assistance to employees – Monitor.al

KLOSI: DO TË SHOHIM MUNDËSINË E RIHAPJES SË TURIZMIT NGA 1 QERSHORI; AGJENSITË KERKOHEN TË SIGUROJNË KUPONAT E FESTAVE - MONITOR.AL



# Presidenti Jaço dhe Përfaqësues të AmCham takojnë Kryetarin e PD-së, z. Lulzim Basha

21 Maj, 2020



**P**residenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, z. Enio Jaço dhe anëtarë të Bordit të AmCham zhvilluan një takim me Kryetarin e PD-së, z. Lulzim Basha dhe Këshilltarët e tij për Çështjet Ekonomike. Takimi u zhvillua me ftesë të Partisë Demokratike. Presidenti i AmCham-it, z. Enio Jaço, shoqërohej nga Atasheu i Seksionit Politik dhe Ekonomik në Ambasadën e SHBA-ve dhe Ex-Officio i Bordit të Dhomës Amerikane, z. Alex MacFarlane, Sekretari i Bordit të AmCham-it, z. Reshard Këlliçi, si edhe nga anëtarja e Bordit znj. Eni Xheko.

Gjatë takimit, u diskutua mbi zh-

villimet e fundit ekonomike të ndikuara nga pandemia COVID-19, prioritetet e bizneseve në tejkalimin e pasojave të krizës dhe rëndësia e përmirësimit të klimës së biznesit. Përfaqësuesit e Dhomës Amerikane të Tregtisë ritheksuan rekomandimet zyrtare të AmCham në lidhje me masat që do të krijonin më shumë mbështetje për bizneset dhe ekonominë e vendit. Ata theksuan gjithashtu se situata politike mbetet një faktor i rëndësishëm që ndikon ndër të tjera në klimën e biznesit në tërësi dhe tërheqjen e investitorëve të huaj. Një pjesë e bisedës u fokusua në masat strukturale që vendi duhet të ndërmarret për përmirësimin afatgjatë të klimës së investimeve në Shqipëri.

## SITUATA E JASHTËZAKONSHME, si kufizohet turizmi nga pengimi i lëvizjes së lirë

Situata e fatkeqësisë natyrore e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është zgjatur deri në datën 23 qershor 2020 duke ruajtur deri në këtë datë të drejtën të kufizojë disa nga liritë themelore të qytetarëve por dhe të bërit biznes.


Zgjatja e afatit të gjëndjes të fatkeqësisë natyrore u prit me reagime nga biznesi sidomos nga sektori i turizmit, i cili pësoi dhe dëmet më të mëdha për shkak të izolimit dhe ndalimit të lëvizjes së lirë. Të dhënat e INSTAT

tregojnë se për muajin prill në Shqipëri hynë vetëm 12 mijë shtetas të huaj, një rënie me 97% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë katër muajve të parë të 2020, numri i vizitorëve të huaj në Shqipëri ka pësuar rënie me 47%, bën të ditur INSTAT.

Paralizimi i turizmit ka një ndikim shumë të madh në ekonominë shqiptare dhe sjell afërisht 22 për qind të PBB. Është kjo arsyeja kryesore pse Shqipëria pritet të ketë rënie ekonomike më të thellë se

ekonomitë e tjera të Rajonit për vitin 2020 sepse sektori i turizmit dhe mikpritjes është një nga shtyllat e forta të ekonomisë. Të ardhurat e ekonomisë shqiptare nga turizmi vitin e kaluar arritën një vlerë prej afro 2.1 miliardë euro, shifra më e lartë e regjistruar ndonjëherë në këtë sektor. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, këto të ardhura u rritën me 12% krahasuar me vitin 2018.

Në nivel global, po raportohet se ndikimi i Covid-19 do të shkaktojë një rënie prej 20 deri 30%



të të ardhurave nga turizmi, duke kapur një vlerë rreth 300-450 miliardë dollarë, që përbën gati një të tretën e 1.5 trilion dollarëve të gjeneruara në 2019 nga ky sektor (të dhëna nga UNWTO 2020).

Ndërkaq duket se efekti dëmtues i lëvizjes së lirë, do të shfrytëzohet për

ti orientuar shqiptarët të pushojnë brenda vendit, duke i dhënë një shans turizmit vendas. Vlerësohet se vitin e kaluar, shqiptarët kanë 1.6 miliardë euro për turizëm jashtë vendit. Kjo ka rritur shpresën se sezoni veror në Shqipëri mund të gjëjë mbështetje kryesisht tek pushuesit vendas.



# GJENDJA E JASHTEZAKONSHME

## KUSH JANË TË DREJTAT QË MUND TË NA KUFIZOHEN

DELOITTE ALBANIA

**Këshilli i Ministrave me anë të vendimit nr. 243, datë 24.03.2020** "Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore" ("Vendimi"), ka vendosur shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Bazuar në këtë Vendim, si rezultat i kësaj gjendjeje mund të realizohet kufizimi i disa të drejtave të garantuara në Kushtetute, deri në masën që konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve.

### TË DREJTAT QË MUND TË KUFIZOHEN JANË SAKTËSISHT:

- » Paprekshmëria e banesës (neni 37);
- » E drejta e zgjedhjes së vendbanimit dhe lëvizja e lirë (neni 38);
- » Shpronësimi kundrejt një shpërblimi të drejtë (neni 41 pika 4);
- » E drejta për të zgjedhur lirisht profesionin (neni 49);
- » E drejta e grevës (neni 51).
- » Ky Vendim parashikon detyrime specifike për institucionet publike, strukturat operationale të sistemit të mbrojtjes civile, subjektet private dhe gjithë shtetasit.
- » Konkretisht, Vendimi ndër të

tjera, parashikon se:

### INSTITUCIONET PUBLIKE:

- të realizojnë plane organizative dhe të vënë në dispozicion burimet njerëzore e logjistike;
- » të kufizojnë aksesin në ambiente publike;
- » të ndalojnë tubimet, manifestimet dhe grevat;
- » të kufizojnë aktivitetet në minimumin e domosdoshëm për të gjitha organet publike;
- » të vendosin në karantinë të gjithë personat e konfirmuar ose të dyshuar dhe të garantojnë kushtet dhe stafin e kualifikuar për kurim të specializuar në qendrat e karantinës.

### STRUKTURAT OPERACIONALE TË SISTEMIT TË MBROJTJES CIVILE:

- » të aktivizojnë dhe të organizojnë procedurën e karantinës për popullsinë e rrezikuar;
- » të organizojnë kontrolle të njëanshme të banesave dhe objekteve private për evidentimin dhe trajtimin e personave të prekur nga virusi;
- » të kufizojnë zhvillimin e aktiviteteve ekonomike për subjektet private në përputhje me nevojat e diktuar nga fatkeqësia natyrore;
- » të organizojnë procedurat e detyruara për kryerjen e shërbimeve

### SUBJEKTET PRIVATE:

- » të respektojnë procedurat dhe masat për karantinën;
- » të informojnë lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile;
- » të përfshihen në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen dhe aftësitë e tyre;
- » të mbyllin ose të kufizojnë përkohësisht veprimtarinë e tyre;



- » të mos vjelin tarifën e kalimit rrugor për mjetet e angazhuara në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

### SHTETASIT:

- » të zbatojnë urdhrat, masat dhe udhëzimet e autoriteteve të mbrojtjes civile;
- » të informojnë dhe ndihmojnë institucionet publike dhe strukturat e mbrojtjes civile duke u përfshirë në detyra të veçanta në përputhje me përgatitjen dhe aftësinë e tyre. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile (KNEC), është organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve

shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore.

Vendimi shpreh gjithashtu se gjitha të drejtat dhe liritë e kufizuara me akte, të dala në zbatim të ligjit nr.15/2016, "Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive", të ndryshuar, dhe me aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për Marrjen e Masave të Veçanta Administrative gjatë kohëzgjatjes së Periudhës së Infeksionit të Shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar, mbeten në fuqi.



**Olta Kazaj,**  
Managing Partner, Avantitive Consulting

### » vijon nga faqja 1

skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar nevojat financiare për kapital qarkullues dhe investime të njësive ekonomike të prekura direkt ose indirekt nga masat ligjore në kuadër të COVID-19, dhe pronësia e të cilave është 100% jopublike.

» Marrëveshjet e garancisë do të jenë sipas kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes

tip bashkëlidhur këtij vendimi dhe do të nënshkruhen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me secilën nga bankat e nivelit të dytë.

- » Shuma e garantuar nga shteti është përcaktuar në nivelin 60% të principalit.
- » Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime tatimore të

paguara për 3 periudhat tatimore njëkohësisht Dhjetor 2019, Janar-Shkurt 2020, përjashtuar tatimpaguesit të cilët kanë lidhur marrëveshje për pagimin me këste të detyrimeve tatimore si dhe tatimpaguesit, detyrimet e paguara të të cilëve janë në proces apelimi në të gjitha shkallët.

- » Vlera e Huasë e vendosur në dispozicion nga Huadhënësi për Huamarrësin mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga Huamarrësi, por në asnjë rast nuk do të jetë më e lartë se 300,000,000 (treqind milion) lekë.
- » Afati i Huasë duhet të jetë

në diskrecion të Huamarrësit, por duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 5 (pesë) vite.

» Huaja mund të jetë në formën e kredisë, overdraft-it, ose linjës së kredisë, e vlerësuar kjo në përputhje me nivelin e riskut të kredisë dhe preferencat e Huamarrësit megjithatë pavarësisht produktit me të cilin do të ofrohet Huaja, periudha pa pagesë principali nuk do të jetë më pak se 6 muaj, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi preferon një periudhë më të shkurtër.

» Huaja do disbursohet në monedhën vendase, dhe norma e aplikuar do jetë sa shuma e interesit referencë/indeksit plus marzhin e bankës (max. 3%), por shuma nuk duhet të kalojë normën 5%.

## PËR GARANCINË SOVRANE ME QËLLIM RIMËKËMBJEN E BIZNESIT



**Kledi Kodra,**  
Managing Partner, Grant Thornton

***Pandemia e një lloji të ri të koronavirusit (COVID-19) po ndikon në mburë globin. Virusi ka shkakuar dëme jo vetëm në jetë njerëzore, por edhe tek bizneset dhe tregjet financiare. Shtrirja e së cilave aktualisht është e papërcaktuar qartë. Subjektet duhet të marrin në konsideratë me kujdes implikimet kontabel të kësaj situatë.***

Ndërsa shpërthimi ka pasur një ndikim pothuajse tek të gjitha subjektet, drejtpërdrejt ose indirekt, disa nga sektorët më të goditur janë linjat ajrore, turizmi dhe shitja me pakicë dhe gjithnjë e më shumë sektorë që vijnë nën radarin e pandemisë me bllokime të vendosura që zbatohen në të gjithë botën. Industria e aviacionit po përballet me ndërprerje masive me kufizimet e udhëtimit të vendosura nga shumica e juridiksioneve. Sektori i mikpritjes është ndikuar nga okupimi i ulët në destinacionet e biznesit dhe të pushimeve, të cilat është dashur të mbylljen plotësisht. Sektorë të tjerë të prekur janë automjetet, veshmbathja, mallra konsumit afatgjatë, farmaceutika, produktet e lëkurës, elektronikën dhe të tjerë ku zinxhiri i furnizimit varet nga vendet më të goditura nga COVID-19. Shërbimet financiare gjithashtu janë prekur nga pamundësia e huamarrësve për të vazhduar me këstet e ripagimit.

Ky artikull identifikon fushat kryesore të raportimit financiar që njësitë duhet të marrin në konsideratë kur përcaktojnë ndikimin në biznesin e tyre, si dhe në rezultatet, pozicionin financiar dhe shpalosjet në pasqyrat e tyre financiare. Kjo nuk është një listë shteruese dhe mund të ketë fusha të tjera që nuk përfshihen në këtë artikull që subjektet duhet t'i marrin në konsideratë. Zonat nuk janë renditur sipas rëndësisë.

#### **CFARË SHENIMESH SHPJEGUESE DUHET TË BËNI NË PASQYRAT FINANCIARE?**

Edhe nëse ka njësi ekonomike të cilat shohin një ndikim të drejtpërdrejtë të pandemisë do të ketë praktikisht një ndikim indirekt për të gjitha njësitë. Ndërsa disa njësi ekonomike mund të mos ndikohen rëndë, dhe disa subjekte madje mund të përfitojnë, shumë pak entitete do të

# Raportimi financiar dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të bizneseve në kushtet e COVID-19



mbeten të pa ndikuar. Prandaj, njësitë ekonomike duhet të marrin në konsideratë ndikimin financiar në njësi ekonomike dhe fushat e pasqyrave financiare që do të preken për të përcaktuar zbulimet e kërkuara. Gjithashtu fushat specifike të raportimit financiar, SNK 1 'Prezantimi i Pasqyrave Financiare' kërkojnë dhënie të informacioneve shpjeguese për burimet e pasigurisë së vlerësimit dhe fushat e gjykimit të rëndësishëm.

#### **ZHVLERËSIMI NGA RËNIA NË VLERË**

Një njësi ekonomike kërkohet të testojë asetat e saj për zhvleresim nga renia në vlerë kur treguesit e rënies në vlerë janë të pranishëm. Një test zhvleresimi duhet të bëhet në përgjigje të treguesve të zhvleresimit përveç testit të detyrueshëm të zhvleresimit çdo vit mbi emrin e mirë dhe aktivet jo-materiale me jetegjatësi të pacaktuar.

Megjithëse disa tregues të zhvleresimit bazohen në informacione të brendshme (p.sh. dëmtimi i pronës, uzinës dhe pajisjeve, planet për të hequr aktivin nga përdorimi), të tjerët shkaktohen

nga ngjarje dhe rrethana të jashtme për njësinë ekonomike. Më poshtë janë disa shembuj të treguesve të dëmtimit që mund të ekzistojnë si rezultat i kushteve ekonomike të shkakutara nga përhapja e COVID-19:

#### **• Investime përveç investimeve të portofolit (p.sh. filiali që nuk është i konsoliduar)**

- vështirësi e konsiderueshme financiare në shoqerine ku kemi investuar  
- një shkelje e kontratës (p.sh. deshtim ose delikuencë në pagesa të borxhit)  
- ka të ngjarë që i investuari të hyjë në falimentim ose në riorganizim tjetër financiar  
- një ndryshim i rëndësishëm negativ në mjedisin ekonomik ose juridik në të cilin punon entiteti i investuar (p.sh. recesioni)  
- zhdukja e një tregu aktiv për investimin për shkak të vështirësive financiare të të investuarit.

#### **• Pronë, uzina dhe pajisje dhe aktivet jo-materiale (përveç emrit të mirë)**

- ndryshime domethënëse në masën ose mënyrën në të cilën aktivi është përdorur

ose pritet të përdoret (p.sh. ndalesa e punës së një makinerie në mënyrë që të ndikohet në kapacitetin e saj të ardhshëm prodhues, një makinë që përdoret në një mënyrë të ndryshme nga qëllimi i saj i synuar - i tillë si për të prodhuar artikuj për të mbështetur betejën kundër COVID-19 - e cila mund të zvogëlojë kapacitetin e saj prodhues në të ardhmen)  
- ndryshime të rëndësishme në faktorët ligjorë ose klimën e biznesit që mund të ndikojnë në vlerën e aktivitetit (p.sh. një njësi ekonomike pret një ulje të eksporteve të saj në një treg të veçantë të huaj si rezultat i mbylljeve për një kohë të të gjatë të kufijve)  
- një rritje në normat e interesit të tregut që do të shkaktonin një ulje të vlerës së aktivitetit në përdorim  
- një rënie ose ndërprerje e nevojës për shërbimet e ofruara nga aktivi.  
Për më tepër, dyshimi për aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar mbi bazen e parimit të vijimesisë është një tregues i përgjithshëm i zhvlerësimit për të gjitha pasuritë.

#### **EMRI I MIRË**

Emri i mirë kërkohet të testohet çdo vit për zhvleresim. COVID-19 mund të ndikojë emrin e mirë përmes:

- Një ndryshim të dukshëm negativ në faktorët ligjorë ose në klimën e biznesit (p.sh. një njësi ekonomike pret një ulje të eksporteve të saj në një treg të veçantë të huaj si rezultat i mbylljeve të gjata të kufijve)
- Humbje e personelit kryesor, dicka jo e përkohshme (p.sh. vdekja)
- Testimi për fshirjen ose zhvlerësimin në kontabilitet të një grupi të konsiderueshëm të aseteve
- Njohjen e një humbje nga zhvlerësimi i emrit të mirë në pasqyrat e veçanta financiare të një investitori
- Një rënie e ndjeshme e çmimit të aksionit të njësisë ekonomike që mund të rezultojë në vlerën kontabel të aktiveve neto të njësisë ekonomike që tejkalon kapitalizimin e saj në treg.

Ndërsa IFRS kërkon që të perdoret vlerësimi më i mirë i mundshëm, është e nevojshme të bëhen skenarë të shumëfishtë rreth vlerësimit më të mirë. Për më tepër, bashkëqepimi i normës së skontimit duhet të vlerësohet me kujdes, në dritën e nivelit të pasigurisë të përfshirë.

Ne numrin e ardhshëm vijojme me:

- Instrumentat financiarë dhe humbja e pritshme kreditore
- Përfitime shtese per punonjesit dhe përfitimet nga shkurtimet
- Te ardhurat
- Inventaret
- Ripagesat e borxhit dhe klasifikimi
- Kontabilizimi i tatimit te fitimit
- Ngjarjet pas dates se bilancit; dhe
- Parimi i vijimesise se biznesit



# COVID-19

## **RAMA: BY MAY, THE COUNTRY WILL BE COMPLETELY OPEN – MONITOR.AL**

“Kryeministri Edi Rama tha ne parlament se brenda muajit maj Shqipëria do të jetë e hapur terësisht, ndërsa vendi do të përgatitet për sezonin e ri turistik.

## **NGA JANARI I VITIT 2021, BANKAT RAPORTOJNË NË BANKËN E SHQIPËRISË EMRAT E 20 HUAMARRËSVE MË TË MËDHENJ - MONITOR.AL**

Duke nisur që nga janari i vitit që vjen bankat tregtare në vendin tonë do të raportojnë çdo tre muaj në Bankën e Shqipërisë 20 kredimarrësit më të mëdhenj. Raportimi po bëhet në kuadër të ndryshimit të Rregullores për Ekspozimet e mëdha që aktualisht është në fazë konsultimi.

## **FINE OF 50 THOUSAND ALL FOR EMPLOYERS WHO DO NOT APPLY FOR FINANCIAL ASSISTANCE TO EMPLOYEES – MONITOR.AL**

Këshilli i Ministrave ka vendosur të gjobisë punëdhënësit që nuk aplikojnë për ndihmën financiare të punonjësve të tyre me një shumë prej 50 mijë lekësh. Kjo masë administrative sanksionohet në disa ndryshime dhe shtesa në AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020.

## **KLOSI: DO TË SHOHIM MUNDËSINË E RIHAPJES SË TURIZMIT NGA 1 QERSHORI; AGJENSITË KËRKOHEN TË SIGUROJNË KUPONAT E FESTAVE - MONITOR.AL**

Përfaqësuesit e Unionit Turistik njoftuan se zhvilluan një takim me Ministrin e Turizmit z.Blendi Klosi, ku diskutuan për situatën aktuale dhe planeve për rihapjen e turizmit. Ministri Klosi tha se do të angazhohej personalisht për realizimin e kërkesave dhe do llojë që rihapja të bëhet e mundur duke filluar nga data 1 qershor, sigurisht duke respektuar protokollin e masave anti covid.

## **2019, PAGESA BANKARE NGA INTERNETI DHE KARTAT U DYFISHUAN - MONITOR.AL**

Gjatë vitit të kaluar 11 nga 12 bankat tregtare në vend e ofruan shërbimin e “home banking”. Banka e Shqipërisë analizon se, këto shërbime po gjejnë një përdorim gjithnjë e më të gjerë në tregun shqiptar, duke u përdorur gjithnjë e më shumë jo vetëm për shërbimet bazike të informimit mbi llogarinë, por edhe për kryerjen e pagesave online.

## **FILLON AKSIONI PËR KONTROLLIN E BIZNESIT, FORMA QË PLOTËSON ISHMT: KONTROLLI SYNON NDERGJEGJESIMIN PËR ZBATIMIN E MASAVE ANTICOID - MONITOR.AL**

Prej disa javësh punonjës të administratës tatimore, të Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (në varësi të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë), të policisë shtetërore kanë nisur aksionin ndërgjegjësues të biznesit për zbatimin e masave kundër Covid-19. “Kontrolli nuk ka si qëllim të gjobisë biznesin, por të sensibilizojë atë për respektimin e masave që nga përdorimi i maskave, dorezave, dezinfektantëve, afishimi i rregullave të publikuara nga e-Albania në pjesën e jashtme të biznesit në mënyrë që mund të shikohet nga klientët”, pohojnë inspektorët e kontaktuar në terren nga Monitori gjatë inspektimit të disa bizneseve në Tiranë.

## **LUFTA KUNDËR COVID / USA, 900 MIJË DOLLARË SHITESË PËR SHQIPËRINË - MONITOR.AL**

Qeveria e Shteteve të Bashkuara, përmes USAID-it, ka angazhuar 900 000 dollarë shtesë për Shqipërinë, në ndihmë të vazhdimit të përpjekjeve kundër pandemisë COVID-19.

## **OBLIGACIONET PRIVATE / CREDINS DHE FIBANK DO TË NXJERRIN EMISIONE TË REJA - SCAN-TV.COM**

Credins Bank dhe Fibank do të kryejnë një emetim të ri të obligacioneve me ofertë private. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka njoftuar se në mbledhjen e ardhshme të Bordit Drejtues do të shqyrtojnë prospektin e ofertës së obligacioneve afatgjatë të dy bankave në fjalë. Credins Bank kryen rregullisht prej më shumë se shtatë vitesh emetim të obligacioneve me ofertë private, të konvertueshme në aksione të zakonshme të bankës. Mbështetur në informacionin e pasqyrave financiare të Credins Bank, në 31 mars 2020 borxhi i varur i bankës kishte vlerën e rreth 6.9 miliardë lekëve.

## **SI I SHPENZOJNË FAMILJET SHQIPTARE PARATË E TYRE? - BB: 24.6 MILIARDE DOLLARË NË VIT, VETËM 1.6% E KONSUMUAR NË TREGJET E LAGJEVE DHE DYQANET - SCAN-TV.COM**

Nga të dhënat e publikimit të fudit të Bankës Botërore rezultojnë se konsumi final i familjeve shqiptare për të mira individuale dhe shërbime, duke përjashtuar kështu shpenzimet e tjera si fatura apo qira, fiksohet në rreth 24.6 miliardë dollarë në vit, sipas paritetit të fuqisë blerëse (PPP), pra të standardizuar me të gjitha vendet e botës për të eliminuar efektin e kursit të këmbimit. Për frymë,

konsumi mesatar i një shqiptari në vit fiksohet në rreth 8500 dollarë të shprehura në PPP.

## **AT THE PEAK OF COVID-19, THE NUMBER OF TOTAL DEATHS FALLS IN THE FIRST QUARTER (246 LESS), THE LOWEST IN THE LAST 4 YEARS – MONITOR.AL**

INSTAT ka raportuar paraprakisht një tendencë rënëse të vdekjeve në tremujorin e parë të vitit, në raport me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Sipas treguesve demografike, të publikuara sot nga INSTAT, 6,115 persona humbën jetën në janar-mars, në krahasim me 6,361 në tremujorin e parë 2019, me një rënie prej gati 4%, ose 246 jetë të humbura më pak.

## **THE PANDEMIC INCREASES THE BUDGET DEFICIT BY 463% IN JANUARY-APRIL, SIGNIFICANTLY INCREASING SOCIAL SPENDING – MONITOR.AL**

Teksa të ardhurat buxhetore shënuan një ulje dramatike gjatë muajit prill, me rreth 30 për qind, për shkak të kufizimeve që shkaktoi pandemia Covid, shpenzimet buxhetore u rritën lehtë në raport me prillin e vitit 2019, duke ndikuar në këtë mënyrë në thellimin e ndjeshëm të deficitit buxhetor.

## **THE VIRUS HITS THE BUDGET. 110 MILLION EUROS LESS IN APRIL, CONSUMPTION FELL 44% - A2 NEWS.COM**

Pandemia goditi rëndë arkën e shtetit gjatë muajit prill, kur ishin në fuqi edhe masat shtrënguese që mbajtën mbyllur pjesën më të madhe të ekonomisë. Të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave tregojnë se për muajin prill, të ardhurat nga tatimet, doganat dhe pushteti vendor ishin 34% më pak se plani i fillimvitit.